Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

## **Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

### **SPECIFIKIME TEKNIKE**

#### **Blerje pjese nderrimi dhe shpenzime për përmirësimin e ndërfaqes për sistemin CMS - IBM**

## Permbajtja

<u>1</u>	<u>HYRJE</u> .....	32
<u>2</u>	<u>OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA</u> .....	32
<u>2.1</u>	<u>Objektivi i Përgjithshëm</u> .....	32
<u>2.2</u>	<u>Qëllimi</u> .....	33
<u>2.3</u>	<u>Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori</u> .....	33
<u>3</u>	<u>LOGJISTIKA DHE KOHA</u> .....	33
<u>3.1</u>	<u>Vendndodhja</u> .....	33
<u>3.2</u>	<u>Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave</u> .....	33
<u>4</u>	<u>PLANIFIKIMI I LEVRIMIT</u> .....	33
<u>5</u>	<u>KËRKESAT TEKNIKE</u> .....	34
<u>5.1</u>	<u>Pershkrimi i Përgjithshëm</u> .....	34
<u>5.2</u>	<u>Skema e Platformes se integruar te kontrollit te monitorimit te sistemeve CMS</u> .....	35
<u>5.3</u>	<u>Pershkrim teknik i komponenteve te infrastruktures se sistemit CMS</u> .....	37
<u>5.4</u>	<u>Kerkesat e Implementimit te Ugrade te VMware</u> .....	39
<u>6</u>	<u>RAPORTIMI</u> .....	39
<u>7</u>	<u>MIRËMBAJTJA</u> .....	40
<u>7.1</u>	<u>Sherbime te Mirembajtjes Proaktive</u> .....	40
<u>7.2</u>	<u>Sherbime Diagnostikimi dhe Riparimi</u> .....	41
<u>7.3</u>	<u>Suport i Nivelit te Dyte</u> .....	42
<u>7.4</u>	<u>Menaxhimi i Sherbimit</u> .....	43
<u>7.5</u>	<u>Nivelet e Sherbimit</u> .....	44

## HYRJE

Albcontrol ka investuar ne ngritjen e metejshme teknike dhe informatizimin e proceseve te perditshme te punes ne kompani. Nder te tjera duke filluar nga viti 2014 ne Albcontrol eshte ngritur dhe vene ne funksionim Platforma e integruar e kontrollit te monitorimit te sistemeve CMS.

Objektivi kryesor i ketij investimi te shtrire ne disa vite eshte mundesimi i monitorimit te konsoliduar, pa marre parasysh llojin e pajisjeve dhe fushat e teknologjise, duke vleresuar faktin se performanca e sherbimeve qe ofron Albcontrol varet ne nje mase te konsiderueshme nga zhvillimi i infrastruktures mbeshtetese ICT.

Platforma e integruar e kontrollit te monitorimit te sistemeve CMS, aktualisht ka kaluar ne tre faza zhvillimi dhe implementimi. Gjate ketyre tre fazave te zhvillimit te projektit eshte mundesuar integrimi i nje numri te madh pajisjesh dhe sistemesh ne platformen e kontrollit te monitorimeve. keto pajisje jane te llojeve dhe funksioneve te ndryshme.

Me perfundimin e fazes se trete te projektit eshte realizuar edhe zgjerimi i sistemit si nga pikepamja e infrastruktures Hardware mbi te cilen mbeshtetet Platforma e integruar e kontrollit te monitorimit te sistemeve, ashtu edhe eshte zgjeruar arkitekta llogjike te sistemit.

Tashme ne kete platforme jane implementuar procese automatike pune qe i mundesojne stafit te Albcontrol te monitorojne ne kohe reale, te njoftohen ne menyra te ndryshme dhe te reagojne ndaj cdo lloj alarmi apo njoftimi te shmangjes se parametrave te punes normale ne secilen prej sistemeve te integruara.

Platforma e kontrollit te monitorimeve eshte bere nje mjet pune mjaft i rendesishem dhe si e tille vleresojme se eshte e nevojshme te mirembahet ne vijim, te zhvillohet me elemente te reja funksionale te cilat evidentohen gjate punes se stafit me platformen CMS.

## OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

### ***Objektivi i Përgjithshëm***

Objektivi i ketij projekti eshte upgrade i platformes se virtualizimit *VMware vSphere Standard 6.7U3* dhe te gjithe komponenteve te saj.

Ky upgrade perkon me versionin me te fundit te certifikuar nga prodhuesi, per infrastrukturen fizike te CMS.

Gjithashtu, Albcontrol kerkon qe te prokuroje sherbimin e mirembajtjes dhe suportit teknik te platformes CMS dhe komponenteve mbeshtetese per nje periudhe 1 vjecare, sipas grafikut te levrimet te specifikuar ne paragrafet e meposhtme.



## Qëllimi

Nepermjet kesaj kontrate, Albcontrol synon zgjidhjen e pikave te meposhtme:

- Implementimin i upgrade te platformes se virtualizimit *VMware vSphere 6.7U3 Standard*
- Rinovimin e licencave dhe suporteve te prodhueseve per komponentet hardware dhe software te platformes CMS
- Mirembajtjen dhe suportin teknik te sistemit te perditesuar per nje periudhe 1 vjecare sipas afateve te percaktuara ne dokument

## Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

- Implementimi i upgrade te platformes se virtualizimit *VMware vSphere 6.7U3 Standard*
- Rinovimin e licensave te prodhueseve per periudhen 1 vjecare
- Ofrimin e sherbimeve te mirembajtjes dhe suportit teknik per platformen e kontrollit te monitorimit te sistemeve ne te gjithe komponentet e tij hardware dhe software.

## LOGJISTIKA DHE KOHA

### Vendndodhja

Shërbimet e mirëmbajtjes do të ofrohen onsite në ambientet e Albcontrol si dhe remote sipas nevojës.

### Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Implementimi I upgrade te platformes se virtualizimit *VMware vSphere 6.7U3 Standard*, si dhe aktivizimi i suporteve te prodhuesit duhet te realizohen brenda 1 muaj nga nenshkrimi i kontrates.

Mirembajtja e platformes se perditesuar do te ofrohet per nje periudhe 1 vjecare nga nenshkrimi i kontrates, sipas grafikut te ekzekutimit te paraqitur ne paragrafet e meposhtme

## PLANIFIKIMI I LEVRIMIT

Nr.	Emërtimi	Sasia
1	Implementimin i upgrade te platformes VMware	1
2	Set Licencash Rinovimi dhe abonime (subscription) 1 vjecar	1
3	Suport dhe mirembajtje 1 vjecare (12 mujore)	12

## KËRKESAT TEKNIKE

### *Pershkrimi i Pergjithshem*

Platforma e integruar e kontrollit te monitorimit te sistemeve CMS mundeson nje monitorim te qenderzuar te pajisjeve ne perdorim nga Albcontrol, pavaresisht nga teknologjia apo funksioni i tyre. Nepermjet implementimit te proceseve automatike te punes, stafi i Albcontrol mund te monitoroje pajisjet ne kohe reale si dhe ka mundesine te njoftohet ne menyra te ndryshme ndaj alarmeve te shfaqura ne sistemet e integruara.

Gjate viteve te fundit ne platformen CMS jane kryer punime te ndryshme, si rezultat i te cilave tashme kemi ne perdorim nje sistem me karakteristikat e mepostme teknike e funksionale:

- Disponueshmeri e larte: Platforma CMS mbeshtetet ne nje infrastrukture te virtualizuar cluster Vmware Vsphere Standard 5.5, me 4 nyje fizike, 1 nyje fizike menaxhimi VMware Vcenter Server 5.5 Standard dhe nje SAN Storage. Nga nyjet fizike, dy prej tyre jane te dedikuara per platformen CMS. Mbi infrastrukturen virtuale jane implementuar servera virtuale, me sistem operimi RHEL 6.5, ne te cilet eshte konfiguruar shtresa mbeshtetese e Aplikacionit te Monitorimit te Integruar. Ky i fundit eshte i bazuar ne produkte IBM te familjes IBM NetCool/Omnibus. Ne platformen CMS jane integruar te gjitha pajisjet e divizionit Operacional dhe Teknik Albcontrol si dhe eshte konfiguruar menyra e mbledhjes, ruajtjes dhe shfaqjes se alarmeve qe gjenerohen nga pajisjet e integruara.
- Shfaqje e dashbordeve ne menyre te qenderzuar: Ne zgjidhjen e platformes CMS jane perfshire 3 monitore te madhesise 55 inch (ca. 139 cm video wall monitor) me teknologjine DIRECT-LED BACKLIGHT super narrow bezel, te cilet perdoren per te shfaqur ne menyre te qenderzuar tabela (dashboarde) me alarme te klasifikuara sipas rendesise, llojit dhe pajisjes qe i gjeneron.
- Funksione te permiresuara te platformes: Aktualisht ne platformen CMS jane konfiguruar sherbimet e Integritimit dhe vetezbulueshmerise se pajisjeve si dhe korrelimi i alarmeve te mbledhura nga pajisjet e integruara. Me qellim ruajtjen e alarmeve per nje kohe me te gjate dhe perdorimin e tyre per pergatitjen e raporteve te ndryshme, jane konfiguruar databaza qe mundesojne pikerisht arkivimin e zgjatur te alarmeve. Gjithashtu, platforma perdor dashboard-in e Tivoli Netcool ne te cilin jane krijuar foldera te dedikuara per cdo kategori sistemi, ku per secilin sistemi eshte krijuar nje faqe me monitor box-e. Vitin e fundit eshte implementuar Moduli IBM Netcool Log Analysis ne nje server te dedikuara cms7 i cili i shton zgjidhjes se integruar CMS mundesi analitike mbi eventet, pasurim te tyre me informacione shtese si dhe observim te detajuar te eventeve.

## Skema e Platformes se integruar te kontrollit te monitorimit te sistemeve CMS

Skema aktuale logjike e Platformes se integruar te kontrollit te monitorimit te sistemeve CMS paraqitet ne Figuren 1.

Arkitektura aktuale fizike mbeshtetet ne nje infrastrukture te virtualizuar cluster Vmware Vsphere Standard 5.5, me 4 servera fizike x3650 M5 te markes IBM, 1 nje fizike menaxhimi VMware Vcenter Server 5.5 Standard. Nga serverat fizike, dy prej tyre jane te dedikuar per platformen CMS. Storage ku ruhen te dhenat eshte i tipit SAN (storage area network) i markes IBM, modeli Storwize V5000. Lidhja midis serverave fizike dhe storage mundesohet nga dy switch-e fiber te markes IBM 2498-X24.

Mbi kete platforme virtualizimi jane ndertuar servera virtuale me sistem operimi RHEL 6.5, me funksione te caktuara sipas arkitektures qe parashtron aplikacioni.




Figura 1

Nje skeme e lidhjes fizike dhe konfigurimit logjik te serverat dhe SAN Storage sa me lart permendur jepet ne Figurat 2 dhe 3.




Figura 2

Ruajtja dhe rikuperimi i te dhenave kryhet nepermjet produktit VMware Data Recovery. Ky produkt ka mundesuar qe te kryhen proceset e meposhtme te ruajtjes dhe rikuperimit:

- Full image backup te makinave virtuale.
- Full dhe incremental recovery te makinave virtuale si dhe rikuperim te file-ve individual dhe direktorive.

Administrimi i infrastruktures se virtualizuar aktualisht behet nepermjet nje server fizik IBM x3550 M4 me system operues Windows Server 2012 R2 Standard Edition, mbi te cilin eshte implementuar platforma e administrimit VMware vCenter Server Standard 5.5.




Figura 3

### ***Pershkrim teknik i komponenteve te infrastruktures se sistemit CMS***

Si rezultat i zhvillimit te projekteve te meparshme ne Albcontrol, aktualisht Platforma CMS mbeshetet mbi keto komponente teknike, qe perbehen nga pajisje hardware dhe Licensa software si me poshte:

### Pajisje

Produkti	SN/SKU	Sasia	Njesia
IBM SystemX 3650 M5	06DAKHK	1	server
IBM SystemX 3650 M5	06EZVNW	1	Server
IBM SystemX 3550 M4	06DHKNB	1	Server
IBM Storwize V5000	7876052	1	SAN Storage
IBM SAN 24B-5	10490MW	1	SAN Switch
IBM SAN 24B-5	10490RT	1	SAN Switch

### Licensa Software

Produkti	Sasia
VMware vSphere 6 Standard for 1 processor	4
VMware vCenter Server 6 Standard for vSphere 6 (Per Instance)	1
Red Hat Enterprise Linux for Virtual Datacenters, Standard	1
IBM Netcool Operations Insight Network Management PA Managed Virtual Network Device	100
IBM Netcool Operations Insight Operations Management 10 Managed Client Devices	182
IBM SW Netcool Operations Insight Operations Management Managed Virtual Network Device	200
IBM Netcool Operations Insight Operations Management PA Managed Virtual Server	40
IBM Netcool Operations Insight PA Connection	1
IBM SmartCloud Application Performance Management Entry Managed Virtual Server	10

Te gjitha pajisjet dhe licencat e mesiperme duhet te rinovohen me suport prodhuesi ose me abonimet perkatese per nje periudhe 1 vjecare.

---

## ***Kerkesat e Implementimit te Ugrade te VMware***

Ne kuader te perditesimit te platformes se virtualizimit nga operatori ekonomik kerkohet:

- Perditesim i platformes se virtualizimit VMware vSphere 5.5 ne versionin me te fundit te certifikuar nga prodhuesi per infrastrukturen fizike te CMS
- Perditesimi I platformes se virtualizimit duhet te kryhet sipas praktikave me te mira, qe ofron prodhuesi.
- Perditesimi duhet te perfshije te gjithe komponentet e infrastruktures virtuale, si ne nivel hypervisor-I, ashtu edhe ne nivel administrimi.
- Nderfaqja e menaxhimit se platformes virtuale duhet te jete e tipit HTML5.
- OE duhet te siguroje, qe platforma virtuale e implementuar te ofroje minimalisht, te njejtat funksionalitete te platformes virtuale ekzistuese.
- OE duhet te siguroje, qe platforma virtuale e implementuar te kete pershtatshmeri maksimale me serverat virtuale ekzistues te platformes CMS.
- Per shkak te kritikalitetit te platformes CMS, OE duhet te siguroje, qe gjate implementimit te minimizojte nderprerjen e perdorimit te platformes CMS nga perdoruesit e Albcontrol.

## **RAPORTIMI**

**Raportet** duhet te perгатiten mbi te dhenat e menaxhimit te problemeve dhe duhet te permbaje minimalisht:

- a) Raportimin mbi implementimin e upgrade te platformes VMware
- b) Raportimin mujor e problemeve te identifikuara
- c) Propozimin e masave organizativo-teknike qe duhen marre me qellim minimizimin e perseritjes se tyre.

Kompania ka per detyre monitorimin e vazhdueshem te sistemeve dhe ne menyre specifike te propozojte nje plan vjetor te aprovuar per menyren e ofrimit te ketyre sherbimeve dhe per kontrollat e logeve te sistemeve qe disponojne te tilla, si dhe nje plan tremujor per perditesime dhe ndryshime nese do te shfaqet e nevojshme gjate mirembajtjes se platformes.

---

## MIRËMBAJTJA

Kompania duhet te ofroje sherbime mirembajtje per te gjithë komponentet e platformes CMS te pershkruar me siper. Gjate periudhes se suportit, Kompania duhet te siguroje se te gjitha komponentet e platformes jane te mbuluar me suport aktiv nga prodhuesit e pajisjeve/software- ve. Sherbimi i suportit duhet te perfshije kontrollin periodike te sistemeve CMS, si dhe perpilimin e raporteve periodike mujore te cilat do te japin nje pershkrim te pergjithshem te performances dhe gjendjes se platformes.

### *Sherbime te Mirembajtjes Proaktive*

**Mirembajtja proaktive** duhet te kryhet ne menyre periodike 2 here ne muaj, per te gjitha sistemet e listuara ne Listen e Pajisjeve Hardware. Te gjitha sherbimet e mirembajtjes parandaluese do te kryhen prane Albcontrol ose remote, pervec rasteve kur Albcontrol percakton nje vendndodhje te re per kryerjen e ketyre sherbimeve.

Kompania duhet te ofroje kontrole periodike 2 javore te cilat duhet te perfshijne si me poshte: Kontroll i statusit te komponenteve hardware per pajisjet IBM Servers, IBM Storage, SAN Switches

- Analizimi i logeve nga IMM per serverat IBM
- Inspektimi i indikatoreve LED
- Kontroll i detajuar i komponenteve hardware nga IMM per serverat IBM
- Kontroll i statusit te komponenteve hardware te storage IBM Storwize
- Kontroll i eventeve te storage IBM Storwize
- Kontroll i portave te SAN Switch dhe komponenteve te tjere hardware per IBM SAN Switch

Kontroll i infrastruktures virtuale VMWare Vsphere

- Kontroll i statusit te makinave virtuale, hosteve ESXi, Cluster VMWare nga Vcenter
- Kontroll i eventeve te infrastruktures virtuale nga VCenter
- Kontroll i sistemit te backup te makinave virtuale VMWare Data Protection

Kontroll i OS dhe i Aplikimeve te Tivoli

- Kontroll i syslogeve te OS RHEL
- Kontroll i utilizimit te burimeve CPU/RAM/Disk /Network per secilen makine
- Kontroll i statusit te komponenteve software te Tivoli Netcool/OMNIBUS:



- 
- SNMP Probe, ObjectServer, ODBC Gateway dhe DB2 Reporter database, Process Agent, WebGui, Tivoli Common Reporting, Message Bus, Log Analysis Server
  - Kontroll i statusit te proceseve te Tivoli Network Manager for IP
  - Kontroll i statusit te proceseve te Tivoli Netcool/Impact

### ***Sherbime Diagnostikimi dhe Riparimi***

Pervec mirembajtjes proactive, Kompania duhet te ofroje edhe **Sherbime Riparimi** ne vendodhje per cdo problem te sinjalizuar nga stafi i Albcontrol ose te verejtura gjate kontrolleve periodike te kryera nga Kompania. Kompania duhet te jete e disponueshme gjate interval kohor, nga e Hena ne te Diele, 24x7, per te ofruar sherbimet e diagnostikimit dhe riparimit per cdo komponent te platformes CMS brenda kohes se percaktuar ne tabelen “Koha e Pergjigjes dhe Zgjidhjes”.

#### ***Nderhyrje per korrigjim gabimesh dhe modifikime eventuale me thirrje nga Albcontrol:***

- Diagnostikim te te gjitha problemeve te lidhura me hardware per serverat IBM, storage IBM dhe IBM SAN Switch-e
- Nderrim te pjeseve Hardware te verifikuara per serverat IBM, IBM Storage, IBM SAN Switches me trajtim sipas termave te garancise nga IBM (Lenovo)
- Kryerja e azhornimeve te firmware-ve, driver-ave te serverave, storage IBM, SAN Switch-eve ne rast problemesh sipas rekomandimeve te IBM (Lenovo)

#### ***Sherbime mirembajtje te lidhura me infrastrukturen virtuale VMWare***

- Diagnostikim dhe riparim te problemeve me infrastrukturen virtuale VMWare Vcenter
- Eskalim te problemeve madhore drejt vendorit VMWare
- Reprovizionim te burimeve te makinave virtuale sipas kerkeses
- Kryerja e VM restore nepermjet Vmware Data Protector ne rast te problemeve madhore te makinave virtuale qe kerkojne restore nga backup

#### ***Sherbime mirembajtje te lidhura me aplikimin***

- Troubleshoot te problemeve te lidhura me OS RedHat me eskalim me supportin e vendorit
- Aplikim e patch-eve, bugfix-eve te RedHat ne rast problemesh sipas rekomandimeve te vendorit
- Troubleshoot te problemeve me Tivoli Netcool/OMNIBUS - Process Agent - PA, SNMP probe – MTTRAPD. Eskalim te problemeve madhore me vendorin IBM
- Troubleshoot te problemeve me Tivoli Netcool/OMNIBUS Process Agent – PA, Object

- Server AGGP. Eskalim te problemeve madhore me vendorin IBM
- Troubleshoot te problemeve me Tivoli Netcool/OMNIBUS Process Agent – PA, Reporter Gateway REP. Eskalim te problemeve madhore me vendorin IBM
- Troubleshoot te problemeve me IBM Webgui, Tivoli Common Reporting Eskalim te problemeve madhore me vendorin IBM
- Troubleshoot te problemeve me IBM Tivoli Network Manager Eskalim te problemeve madhore me vendorin IBM
- Troubleshoot te problemeve me Tivoli Netcool Impact ne serverin cms5. Eskalim te problemeve madhore me vendorin IBM
- Modifikim / shtim i filtrave ne WebGui per te reflektuar ndryshimet e kryera ne AEL
- per domainet e integruar, ne rastet kur ka shtim/modifikim te pajisjeve neper domain
- Modifikim / shtim i view ne WebGui te AEL per perdoruesit e sistemit
- Modifikim dhe shtim te faqeve ne WebGui per paraqitjen vizuale te eventeve ne Dashboard ne formatet e hartave, Monitor Box, AEL etj
- Modifikim i Netcool/OMNIBUS Probe rule files ne rast se do kerkohen pershtatje ne nivel eventesh per pajisjet e integruara ne CMS (psh modifikim pershkrimi, severiteti, etj)
- Konfigurimi i politikave te sigurise per perdoruesit e sistemit
- Konfigurim i politikave te network polling dhe network discovery ne ITNM sipas nevojave te AlbControl dhe sistemeve te integruara me CMS.
- Krijimi i view te personalizuar te Network ne ITNM WebGui
- Mbeshtetje ne konfigurimin/testimin e SNMP ne pajisjet qe shtohen ne listen e domain-eve te integruara ne CMS dhe integrimi me CMS nqs eshte pajisje e re dhe nevojitet shtim i Netcool rule files respekti

*Shenim: Teknikeve te kompanise do t'ju sigurohet akses ne pajisjet hardware, software te platformave si dhe programeve aplikative on-site, ne pranine e specialisteve te Albcontrol. Baza e te dhenave do te ruhet me kujdes dhe do te mbikeqyret nga specialistet e Albcontrol per te garantuar sigurine e te dhenave qe perdor aplikacioni. Gjithashtu do te rregjistrohen te gjitha veprimet qe do te kryejne tekniket e kompanise. Suporti remote do te kryhet nepermjet kanaleve te sigurta VPN me aprovimin e te dy paleve per te mos cenuar rendesine e informacionit qe ruhet ne sistem.*

## ***Suport i Nivelit te Dyte***

Ne rastet kur nevojitet **eskalimi i ceshtjeve tek prodhuesit**, Kompania do te jete pergjegjese per raportimin e problemit tek prodhuesit, ndjekjen dhe riparimin e tij brenda kohes se percaktuar ne kete dokument. Per kete qellim, kerkohet qe sherbimet e nivelit te dyte te ofrohen nga kompani te autorizuar nga prodhuesit per levrime te sherbimeve perkatese.

---

Te gjitha incidentet apo defektet e ndodhura ne platformen e CMS duhet te raportohen ne raportet qe do t'i dorezohen Albcontrol. Ne raport do te paraqiten edhe veprimet e ndermarra per korrigjimin e problemeve, koha e riparimit dhe detaje te tjera teknike. Per ndertimin e formulareve te raportimit Kompania do bashkepunoje me stafin teknik te Albcontrol per detaje te metejshme.

## ***Menaxhimi i Sherbimit***

Operatori Ekonomik duhet te ofroje takime periodike duke organizuar, administruar dhe menaxhuar takimin dhe follow-up. Per kete qellim, Operatori Ekonomik duhet te vendose ne dispozicion nje skuader te dedikuar e cila do te jete pjesemarrese ne prodhimin e planit e Komunikimit dhe te percaktoje:

- daten, kohen, vendndodhjen e takimeve
- scope-n e shqyrtimit, cilat sherbime do merren ne shqyrtim

Takimet duhet te kene qellim trajtimin e ceshtjeve te meposhtme dhe jo vetem:

- Sherbimet qe ne menyre te konsiderueshme kane kerkuar me shume perpjekje ose investim per t'u permbushur nga sa ishte planifikuar.
- Sherbimet ku ka patur ndryshime te rendesishme ne mjedisin e punes
- Sherbimet me ndikim te rendesishem ne arritjen e nivelit te sherbimit, ne biznes, apo per klientet dhe perdoruesit
- Shqyrtimi nga "mesimet e nxjerra", minuta, dhe planet e veprimit nga shqyrtime te meparshme SLA te zgjidhjes se sherbimit ose zgjidhje te ngjashme te sherbimit, te vemendjes se veçante.

## Nivelet e Sherbimit

Kompania duhet te ofroje mbulim te sherbimit 24x7 me kohe pergjigje sipas tabelës se meposhtme:

Kategoria 1 (Kritik/ I Larte)	Kategoria 2 (I Mesem)	Kategoria 3 (I Ulet)
Nderprerja e komunikimeve te te dhenave prek mbi 70 % te sistemeve ne suport	Nderprerja e komunikimeve te te dhenave prek mbi 15 % sisteme ne suport	Nderprerja e komunikimeve te te dhenave prek nen 15 % te sherbimeve ne suport
<b>Numri i perdoruesve te ndikuar</b>		
Mos funksionimi ndikon nje numer <b>shume te madh</b> te perdoruesve	Mos funksionimi ndikon nje numer <b>te vogel</b> te perdoruesve	Mos funksionimi ndikon pjeserisht vetem perdoruesit e nje departamenti/njesie
<b>Pezullimi i punes</b>		
Mos funksionimi pengon perdoruesit <b><u>te realizojne pjesen me te madhe te punes se tyre.</u></b>	Mos funksionimi pengon perdoruesit <b><u>te realizojne pjese te punes se tyre qe kane lidhje krvesisht me institucione te tjera.</u></b>	Mos funksionimi pengon perdoruesit <b><u>te realizojne disa pjese te vogla te punes se tyre.</u></b>
<b>Zgjidhje alternative e perkohshme</b>		
<b><u>Nuk ka nje menyre alternative</u></b> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.	<b><u>Ka pjeserisht nje menyre alternative</u></b> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.	<b><u>Ka nje menyre alternative</u></b> te perkohshme dhe te pranueshme per zgjidhjen e problemit.
<b>Koha e pergjigjes</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Brenda 30 minutash</li> <li>○ Ne vend brenda 3 oreve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Brenda 4 ore</li> <li>○ Ne vend brenda 6 oreve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Brenda Dites Tjeter te Punes</li> <li>○ Ne vend Brenda 2 diteve</li> </ul>

---

## **Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet: “Blerje pjese nderrimi dhe shpenzime për përmirësimin e ndërfaqes për sistemin CMS - IBM”**

**(Sipas Shtojces 5 ne DST, specifikimet teknike)**

**Afatet e lëvrimit: 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontrates**

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

**Argumentimi:** kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja mesatare vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2018,2019,2020), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e **fondit limit** në procedurën e prokurimit ose

2.2.2 Bilancet e viteve 2018, 2019 dhe 2020 miratuar nga organet perkatese shtetore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

**Argumentimi:** Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese kontrata ku te kete realizuar sherbime te ngjashme, në një vlerë sa 40 % e fondit limit që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga *nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*. Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe të jenë të deklaruara në organet tatimore.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar përvojë e ngjashme të jenë në vlerën jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te paraqese certifikatat qe vertetojne perputhshmerine me standardet:

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerise.
- **ISO 27001-2013**, Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Informatike ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerise.
- **ISO 20000-1:2011**, Sistemi per Menaxhimin e Sherbimeve ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerise.

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, Ose ekuivalente me to.

**Argumentim:** *Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

*Sqarojmë se Albcontrol sha, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane 1035/2011 dhe të audituar nga ana e Agjensisë Europiane të Sigurisë së aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë komptibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtare të Aviacionit Civil sipas Rregullores se Komisionit European EC 552/2004 si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative. Albcontrol*



---

është gjithashtu i certifikuar, për shkak të natyrës së aktivitetit me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, ISO 27001:2013, ISO 20000-1:2018, SES (Reg 2017/373).

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

Menaxhimi i shërbimit IT siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose distributoret e autorizuar, apo të tjere lejuar/certifikuar/autorizuar nga prodhuesi si dhe marreveshjen e bashkepunimit me prodhuesin e Sistemit CMS (IBM), ku të evidentohet statusi i partneritetit si Solution Provider. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77/2 të LPP: Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Sherbimet e suportit për sistemin CMS përfshijnë dhe shërbime të mirëmbajtjes të teknologjive standarde IBM në të cilën është implementuar sistemi CMS, rrjedhimisht është e domosdoshme që operatori fitues të jetë i autorizuar për lehtësimin e këtij suportit nga prodhuesi IBM apo nga të tjerë të autorizuar nga IBM për këto në Shqipëri. Kjo siguron që shërbimet e ofruara janë genuine (që rrjedhin nga IBM) dhe minimizon riskun për mos respektimin e kushteve të kerkuara mbi kohën dhe cilësinë e dhenies së shërbimit për teknologjinë standarde në fjalë. Në të njëjtën kohë duke patur parasysh që zgjidhja është specifike prodhuesi IBM ka një rrjet kompanish të quajtura Solution Provider me anë të të cilave implementon dhe suporton zgjidhjet e tij. Për këto kërkohej prove partneriteti me këto status.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë status partneriteti me prodhuesin VMware të pakten të nivelit Advanced ose ekuivalent, me qëllim ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes për infrastrukturën virtuale VMware, ku mbështetet sistemi CMS.

**Argumentim:** Sherbimet e suportit dhe të upgrade të platformës VMware janë shërbime që do të kryhen e levrohen në teknologji standarde të percaktuara, të implementuara me pare, rrjedhimisht është e domosdoshme që operatori fitues të ketë një status të caktuar partneriteti me këto Prodhues. Statusi i Partneritetit Advanced tregon që OE ka provuar tek prodhuesi VMware aftësitë e tij në lidhje me teknologjinë perkatese. Kjo siguron që shërbimet e ofruara janë të një kualiteti të lartë (që provohen nga Prodhuesi) dhe minimizon riskun për mos respektimin e kushteve të kerkuara mbi kohën dhe cilësinë e dhenies së shërbimit për teknologjinë standarde në fjalë.

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë të gjithë stafin dhe personelin tekniko-profesional, i cili do të angazhohet në shërbimet e kerkuara. Në përberje të stafit Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht stafin e mëposhtëm.

---

a) Te pakte 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi per sistemet IBM Storwize Storage ose ekuivalent.

b) Te pakte 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi per serverat IBM/Lenovo ose ekuivalent ku mbeshtetet sistemi CMS

**Argumentim:** Duke qene qe sistemi CMS eshte implementuar ne Hardware – Serverat IBM/Lenovo dhe storage IBM ne menyre qe te sigurohet dhe me qene se kerkohet suporti teknologjik i ketyre pajisjeve atehere per te siguruar mbarevajtjen e kontrates kerkohen qe per secilen teknologji te jene te pakten 2 persona te kualifikuar nga prodhuesi per teknologjine perkatese.

c) Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar nga prodhuesi IBM si IBM Certified Associate per netcool/omnibus v7.4 ose ekuivalent

**Argumentim:** Duke qene qe sistemi CMS bazohet ne zgjidhjen teknologjike te prodhuesit IBM netcool/omnibus v7.4 atehere qe te sigurohet suporti i kesaj zgjidhjeje Operatori Ekonomik duhet te provoje qe ka personelin e afte qe e njej kete zgjidhje. Gjykohet qe per te siguruar mbarevajtjen e kontrates te kerkohet qe Operatori Ekonomik te kete ne stafin e tij te pakten 1 person i kualifikuar nga prodhuesi per teknologjine ku bazohet kjo zgjidhje. Certified Associate eshte certifikata e prodhuesit IBM qe verteton kete.

d) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi IBM Certified Database Associate - DB2 ose ekuivalent per bazen e te dhenave mbi te cilen mbeshtetet sistemi CMS.

**Argumentim:** Duke qene qe sistemi CMS eshte implementuar ne nje platforme te ngritur mbi Data Bazen e teknologjise DB2 te IBM atehere qe te sigurohet suporti i plote kesaj zgjidhjeje Operatori Ekonomik duhet te provoje qe ka personelin e afte qe e njej kete Data Baze. Gjykohet qe per te siguruar mbarevajtjen e kontrates te kerkohet qe Operatori Ekonomik te kete ne stafin e tij te pakten 2 persona te kualifikuar nga prodhuesi per teknologjine e Bazes se te Dhenave ku eshte implementuar kjo zgjidhje. Certified Database Associate - DB2 eshte certifikata e prodhuesit IBM qe verteton kete.

e) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar ne teknologjine e virtualizimit Vmware te nivelit professional ose ekuivalent, me qellim ofrimin e sherbimeve te mirembajtjes per infrastrukturen Vmware ku mbeshtetet sistemi CMS.

**Argumentim:** Duke qene qe sistemi CMS eshte implementuar ne nje platforme te virtualizuar te ngritur mbi teknologjine specifike VMware atehere qe te sigurohet suporti i plote kesaj zgjidhjeje Operatori Ekonomik duhet te provoje qe ka personelin e afte qe e njej kete teknologji virtualizimi ne nivelin profesional apo ekuivalent. Gjykohet qe per te siguruar mbarevajtjen e kontrates te kerkohet qe Operatori Ekonomik te kete ne stafin e tij te pakten 2 persona te kualifikuar nga prodhuesi per teknologjine e virtualizimit VMware.

f) - Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar si IBM Service Management

**Argumentim:** Per te siguruar mbarevajtjen e kontrates nga aspekti i manaxhimit te ofrimit me cilesi te sherbimeve dhe bazuar ne metodologji boterore dhe specifike te prodhuesit IBM, prandaj OE duhet te vere ne dispozicion te kontrates dy punonjes te certifikuar ITIL dhe nje nga prodhuesi IBM per teknologjine e tij te menaxhimit te sherbimit per te siguruar mbarevajtjen e saj.

g) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per ITIL ose ekuivalent me qellim menaxhimit e sherbimeve te suportit dhe mirembajtjes”

**Argumentim:** Per te siguruar mbarevajtjen e kontrates nga aspekti i manaxhimit te ofrimit me cilesi te sherbimeve dhe bazuar ne metodologji boterore dhe specifike te prodhuesit IBM, prandaj OE duhet te vere ne dispozicion te kontrates dy punonjes te certifikuar ITIL dhe nje

---

*nga prodhuesi IBM per teknologjine e tij te menaxhimit te sherbimit per te siguruar mbarevajtjen e saj.*

Personeli i mesiperm duhet te kete aktualisht nje marredhenie pune me ofertuesin jo me pak se 1 (nje) muaj, e vertetuar kjo me formularet E-sig te listepagesave te deklaruar dhe te firmosura nga inspektorët tatimore. Aftesite e tyre teknike duhet te vertetohen me ane te certifikatave ose transkripteve (ne rastin kur aplikohet) te leshuara nga prodhuesi.

Operatori Ekonomik duhet te deklaroje disponueshmerine e secilit specialist per tu angazhuar gjate gjithë afatit te kontrates

**Argumentim:** Kriteret e mësipërme janë në përputhje me parashikimet e nenit 41 pika 4 dhe pika 6 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet se: “a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*”

*“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*

*Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## Shtojca 8.

